



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

6 DENONCIME TË DEPOZITUARA PËR PROKUROREN/DREJTUESEN E PROKURORISË SË RREHIT GJYQËSOR KORÇË ZJ. DHORINA THEODHORI.

Shorti për subjektin e rivlerësimit Znj. Dhorina Sollaku prokurore/drejtuese në Prokurorinë e Rrehtit Gjyqësor, Korçë ishte hedhur më 15.03.2019. Subjektit i ish-in lënë 6 ditë kohë për t'u njohur me dosjen dhe në datën 16.04.2016 kishte dorëzuar parashtrime dhe prova në lidhje me hetimin e bërë ndaj saj.

Në lidhje me pasurinë relatorja e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (KPK) referoi se lidhur me apartamentin e banimit me sipërfaqe 67m², 1/6 pjesa takuese, trashëgimi ligjore përfituar nga babai i Znj. Theodori me anë të privatizimit në vitin 1993, subjekti ka deklaruar shtesë 12m² në proces legalizimi, me burim të ardhurash nga babai. Sipas hetimit të KPK kjo shtesë nuk rezulton e deklaruar ne Deklaratën Vetting të viteve 2009-2014.

Gjithashtu nga KPK u cilësua si shfrytëzim i burimeve njerëzore shlyerja e disa pagesave të një kredie konsumatore në Raiffeisen Bank, nga persona të tjerë me iniciale A.K dhe K.L punonjës në Prokurori, kredi e cila arrin në vlerën 1 milion lekë.

Në lidhje pastërtinë e figurës dhe aftësive profesionale, nga raporti i DSIK konkludohet në përshtatshmëri për vazhdimin në detyrë të Znj. Theodhori. Raporti i Prokurorisë së Përgjithshme lidhur me aftësitë profesionale ishte pozitiv për subjektin e rivlerësimit.

Lidhur me denoncimet nga publiku, pranë KPK ish-in depozituar 6 denoncime, njëri prej tyre pranë ONM.

Denoncimi I: Shtetasi I.Z ku rezulton nga hetimi i bërë nga KPK se subjekti i rivlerësimit kishte bërë të gjitha veprimet procedurale të sakta.

Denoncimi II dhe III: Shtetasi Xh. C dhe nga një person anonim nuk rezultojnë shkaqe apo rrethana për veprime korruptive të njëanshme nga ana e Znj. Theodhori.

Denoncimi IV: Shtetasi A. Xh. F i cili i është drejtuar zyrës së Prokurorisë Korçë, duke bërë një kallëzim dhe pretendon se nuk ka marrë përgjigje, as kur subjekti i rivlerësimit ka marrë detyrën si drejtuese e prokurorisë. Kryesuesja e trupit referoi që për këtë rast i ishte kaluar barra e provës subjektit.

Denoncimi V: Shtetasi V.N, për të cilin KPK nuk kishte gjetur shkaqe apo rrethana për veprime të njëanshme.

Denoncimi VI: Shtetasi B.M, ankues edhe pranë ONM, pretendon se subjekti i rivlerësimit nuk e ka tërhequr dosjen pranë gjykatës para vendosjes së mos fillimit të procedimit.

Lidhur me këtë denoncim ishte anëtarja e trupit gjykues e cila i drejtoi pyetje Znj. Theodhori lidhur me njohuritë teorike mbi rastet e mos fillimit të procedimit.

Këto janë të dhëna paraprake të referuara nga vëzhguesit e KShH-së. Raporti përfundimtar me gjetjet e plota për të gjitha seancat e monitoruara do të publikohet së shpejti nga KShH.